

**U D H Ë Z I M**  
**Nr.27, datë 28.4.2001**

**PËR KOHËN E PUNËS SË KZQV-VE**

Në mbështetje të nenit 18/2 dhe 38/7 të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

**U D H Ë Z O N:**

1. Orari i punës i KZQV-ve dhe QRLZ-ve (Qendrave të Rishikimit të Listave të Zgjedhësve), gjatë gjithë periudhës së rishikimit të listave, duhet të jetë 8.00 – 12.00 paradreke dhe 15.00 – 19.00 mbasdite, pranë zyrave të bashkive, komunave apo njësive bashkiake përkatëse.

2. Gjatë periudhës së rishikimit të listave, anëtarët e KZQV-ve do të shkëpusin marrëdhëniet e punës që ato kanë me punëdhënësit e tjerë. Gjatë kësaj periudhe, në orën që përcaktohet në pikën nr.1 të këtij udhëzimi, ata do të punojnë pranë zyrave të bashkive, komunave apo njësive bashkiake.

3. Anëtarëve të KZQV-ve, që punojnë për këtë periudhë, do t’u ruhet vendi i punës dhe marrëdhëniet financiare do t’ju vazhdojnë rregullisht si më parë, pranë punëdhënësve të tyre.

4. Anëtarët e KZQV-ve, për periudhën që do të punojnë me kohën e punës të përcaktuar në këtë udhëzim, do të shpërblehen në masën që do të caktohet me vendim të veçantë të KQZ-së.

5. KZQV-të do të vazhdojnë të funksionojnë si institucion i përhershëm edhe për periudhën pasi ka mbaruar procesi zgjedhor.

Për këtë periudhë, anëtarët e KZQV-ve do të paraqiten në punë një herë në muaj, ditën e shtunë të javës së parë të muajit përkatës, nga ora 8.00 – 12.00 paradreke dhe shpërblimi për këtë punë të kryer do të caktohet me një vendim të veçantë të KQZ-së.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Ilirjan Celibashi**